

## **Rihapet Thirrja për 2 (dy) Bursa për studentët në Programin Erasmus+ në Universitetin e Aradit “Aurel Vlaicu”, Rumani**

Në kuadër të Programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për 2 (dy) bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Sporteve të Tiranës /Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në Universitetin e Aradit “Aurel Vlaicu”.

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor (Studentët duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Bachelor në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit - Universitetin e Sporteve të Tiranës)

Kohëzgjatja e bursave:

- o Shtator – Dhjetor 2020 (4 muaj)

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara <http://www.uav.ro/>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (deri në 800 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (275 EUR)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Procedura e Aplikimit dhe Dokumentat e nevojshme për aplikim:

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët **Bachelor**:

- ✓ CV (kontaktet e perfshira);
- ✓ Letër Motivimi;
- ✓ Foto personale 4 copë;
- ✓ Kopje e mjetit të identifikimit (ID/Pasaportës);
- ✓ Vërtetim studenti;
- ✓ Listë notash në anglisht;

- ✓ Letër reference nga staf akademik me kategorine “Profesor”
- ✓ Certifikatë e gjuhës së huaj\*; (jo obligative)

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Aradit “Aurel Vlaicu” lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e pare prt vitin akademik 2020-2021 në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Kriteret mbi bazën e të cilave do të përzgjidhjet student fitues janë:

- ✚ Të njohë gjuhën angleze vleresuar nga komisioni special (testim + intervistë)
- ✚ Të këtë notën mesatare të te studimeve aktuale sa me larte.
- ✚ Preferohen student qe ndjekin ciklin e pare te studimeve Bachelor, viti i pare.

Afati për aplikim: **31.03.2020**

Periudha e mobilitetit: Studentët e përzgjedhur për të ndjekur këtë program mobiliteti do të fillojnë mësimin për një periudhë 4 mujore ndërmjet datave Shtator 2020 – Dhjetor 2020.

I gjithë procesi i aplikimit kryhet online.

Për të aplikuar dërgoni me email dokumentat e skanuar në formatin pdf. në adresen: [sshabanaj@ust.edu.al](mailto:sshabanaj@ust.edu.al);

Për më shumë informacion mbi bursat mund të kontaktoni Zyrën për Koordinimin, Marrëdhëniet me Jashtë, Këshillit të Karrierës dhe Alumnit, kati i II nga e hena në të premtë ora 10:00 – 12:00 si dhe në adresën: [sshabanaj@ust.edu.al](mailto:sshabanaj@ust.edu.al)

Universiteti i Sporteve të Tiranës ju uron Suksese në aplikim!